



PLANI I ZHVILLIMIT I BASHKISE KRUME



PLANI I ZHVILLIMIT I BASHKISE KRUME

(QARKU I KUKESIT)

Tetor 2012

PARATHËNIE

Plani i Veprimit dhe Zhvillimit të Komunës Krumë është realizuar në kuadër të projektit “Fuqizimi i Rolit të Komunitetit në Planifikimin Strategjik për Zhvillimin Lokal” i financuar nga Balkan Trust for Democracy dhe implementuar nga RASP (program Mbeshtetjes së Shoqatave Rurale), dhe është realizuar në bashkëpunim me Qendrën “Integrim dhe Zhvillim Demokratik, dhe Komunën Krumë.

Balkan Trust for Democracy (BTD) është një iniciativë me një histori veprimtare 10 vjeçare, që mbështet demokracinë, qeverisjen e mirë dhe integrimin Euroatlantik në Europën Juglindore. Ky partneritet publiko-privat, që ka fituar mjaft çmime është krijuar fillimisht në vitin 2003 nga German Marshall Fund i SH.B.A, Agjensia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Kombëtar (USAID) dhe Fondacioni Stewart Mott.

RASP (Programi i Mbeshtetjes të Shoqatave Rurale) është një organizatë me qendër në Tiranë, misioni i së cilës mbështetet në stimulimin e mundësive për banorët e zonave rurale për të përmirësuar jetesën dhe reduktuar varfërinë, nëpërmjet shfrytëzimit të mirë të burimeve natyrore, kulturore dhe njerezore për të arritur një zhvillim të qëndrueshëm. RASP ka një eksperiencë të gjatë në zhvillimin e projekteve me pjesëmarrje të gjerë të komunitetit dhe në fokus të këtyre projekteve është zhvillimi i zonave rurale, forcimi i demokracisë dhe rolit të shoqërisë civile në planifikim, hartim dhe implementim të dokumenteve strategjike, planeve të zhvillimit, veprimit të zonave ku ata jetojnë .

Qendra e Keshillimit të Grave dhe Shërbimeve Sociale ka si mision të saj ofrimin e programeve dhe shërbimeve për gratë dhe vajzat në nevojë në rajonin e Kukësit ku ushtron aktivitetin e saj por jo vetëm. Përfshirja e QKGSHS-së ka qënë thelbësorë në punë me komunitetin e Komunës Krumë për të rritur ndërgjegjësimin dhe aktivizimin e përfaqësuesve të këtyre komuniteteve në planifikimin strategjik për zhvillimin lokal.

Synimi i këtij dokumenti është të ofrojë Pushtetit vendor, Qeverisë shqiptare, donatorëve bilateral dhe multilateral, organizatave Qeveritare dhe jo Qeveritare një program zhvillimi për promovimin e mbështetjes dhe investimeve të shërbejë si një mekanizëm planifikues, i cili kombinon prioritetet sipas sektoreve dhe fshatrave, prioritetet të cilat janë artikuluar nga drejtues të organeve vendore.

Plani i zhvillimit - Bashkia Krume

Komuna Krumë ka nje potencial te madh zhvillimi, me bukuri te vecante natyrore dhe ne kete kuader Plan i Zhvillimit dhe Veprimit i Komunës Krumë synon të përmbledhë të gjitha prioritet e zones në një “dokument” të vetëm që do shërbejë si një guidë në zhvillimin e komunes ne te ardhmen. Me mbështetjen e pushtetit lokal është realizuar një proces pozitiv për hartimin e këtij plani me nje pjesemarrje te gjere te komunitetit duke zbatuar Kodin e praktikës së mirë në të gjitha hallkat e tij si Përcaktimi i axhendes, Draftimi, dhe miratimi, dhe ky proces do te vazhdoje edhe me fazat e Implementimit, Monitorimit dhe Riformulimit.

TABELA E PERMBAJTJES

Parathënie.....	3
TABELA E PERMBAJTJES.....	5
Plani i zhvillimit bashkia Krume	7
Hyrje – Vlerësim i përgjithshëm.....	7
Hapat e ndjekur në hartimin e Planit të Veprimit (PV)	10
Përmbledhje e profilit të Bashkisë Krume	11
Historiku i qytetit të Krumes.....	11
Pozita gjeografike	12
Popullsia.....	14
Table 1 Të dhëna për popullsinë	14
Ndihma ekonomike	15
Table 2 Familje me ndihmë ekonomike.....	15
Strehimi dhe urbanizimi.....	15
Furnizimi me Ujë të Pijshëm	15
Rrjeti i kanalizimeve	16
Burimet dhe Përdorimi i Energjise	16
Sistemi Arsimor	16
Table 3 Te dhëna për edukimin.....	17
Shëndeti Publik	17
Mjedisi dhe Gjelbërimi	17
Table 4 Sipërfaqjet në m ² dhe numri i pemëve	18
Mbetjet Urbane	18
Infrastruktura Rrugore	20
Table 5 Të dhëna për infrastrukturën rrugore	20
Bizneset dhe Punësimi	20
Te ardhurat e Bashkisë Krume.....	21

Plani i zhvillimit - Bashkia Krume

Tabela 7 Numri i personelit Viti 2011	21
Tabela 8, Grandet dhe buxheti sipas viteve 2007 – 2012 Në lekë 21	
Table 9. Buxheti për vitin 2012 – Bashkia Krume	22
Objektivat e pergjithshem te zhvillimit te Bashkise Krume	23
Matrica e projekteve sipas viteve.....	24
Matrica e projekteve 2012	24
Matrica e projekteve 2013	26
MATRICA E PROJEKTEVE VITI 2014.....	30
Matrica e projekteve Viti 2015	31
Hartim Projekti.....	32
Preventi dhe realizimi i projektit.....	32
Preventi dhe realizimi i projektit.....	33
Anex 1. Grupi konsultativ Krume.....	34
Vendimi i keshillit bashkiak	35

PLANI I ZHVILLIMIT BASHKIA KRUME

HYRJE – VLERËSIM I PERGJITHSHËM

Panifikimi dhe përmirësimi i shërbimeve publike është një proces që duhet shoqëruar me reformat administrative dhe të menaxhimit, rritjen e komunikimit, pjesëmarrjen e qytetarëve. Kjo do të sigurojë një qeverisje lokale të përgjegjshme dhe transparente. Kjo gjë mund të realizohet nëse administrata e Qeverisjes Lokale do të hartonte një Plan Zhvillimi. Ne e mbështetëm Administratën e Bashkisë Krumë në realizimin e të gjithë hapave të duhur deri në finalizimin e këtij dokumenti.

Ky dokument udhërrëfyes, i cili identifikon prioritetet kyçe të zhvillimit të ardhshëm të Bashkisë, duke orientuar çështje si ato të zhvillimit ekonomik, ndërhyrjet për përmirësimin e infrastrukturave fizike dhe sociale, shpërndarjen dhe kapacitetet e nevojshme të shërbimeve publike, planifikimin dhe menaxhimin e territorit etj, tashmë është në dispozicion të aplikuesve.



Plani i Zhvillimit të Bashkisë Krumë është produkt i një procesi të hapur pjesëmarrjeje disamujore, i udhëhequr nga grupi i punës, i përfshirë në një cikël takimesh debatuese dhe konsultative. Janë përfshirë në këtë proces përfaqësues të administratës vendore të Bashkisë, Këshillit të Bashkisë, grupe të ndryshme interesi lokal

(intelektuale, biznesmenë, gra, të rinj), përfaqësues të organizatave jofitimprurëse (OJF) si dhe partnerë të tjerë që janë duke ushtruar veprimtarinë e tyre në territorin e Bashkisë.

Nxitja e pjesëmarrjes së komunitetit, bazuar në forma jodiskriminuese dhe paanshmëri në lidhje me moshën, gjininë, racën, etninë, përkatësinë fetare apo bindjet politike, i ka shërbyer qëllimit për të siguruar legjitimitet dhe konsensus ndërmjet palëve lidhur me planin, afrimin e komunitetit në vendimmarrje, rritjen e nivelit të transparencës së autoriteteve vendore gjatë ushtrimit të detyrave të veta administrative, dhe shkallës së ndërgjegjësimit mbi gamën e shqetësimeve dhe

Plani i zhvillimit - Bashkia Krume

pritsmërive që mbart komuniteti vendas, të gjitha këto si elemente të rëndësishëm për një qeverisje të mirë.

Plani i Zhvillimit të Bashkisë Krume i shërben rritjes së mirëqënies së të gjithë komunitetit. Plani identifikon një proces të tërë, në të cilin angazhohen jo vetëm strukturat e administratës lokale të Bashkisë, por edhe aktorët kryesorë, grupet e interesit dhe banorët e Krumes.

Falë përfshirjes së komunitetit në procesin e përgatitjes së tij, Plani i Zhvillimit orientohet sipas koncepteve vizionare të komunitetit në lidhje me zhvillimin. Ky plan është konceptuar si një marrëveshje mes autoriteteve vendore dhe qytetarëve, e cila përcakton llojin, sasinë dhe formën e zhvillimit, duke mbrojtur me çdo kusht mjedisin dhe vlerat. Për këtë arsye plani është i fokusuar të ndërtojë një program pune me një plan veprimesh konkrete, që synon të fillojë dhe të influencojë proceset e ardhshme të zhvillimit. Plani adreson premtimet e bëra nga Kryetari i Bashkisë Krume gjatë fushatës zgjedhore, nevojat bazë, kërkesat dhe sfidat e banorëve, nëpërmjet shfrytëzimit racional të potencialeve dhe burimeve ekzistuese.

Duke u bazuar në Ligjin ekzistues të Qeverisjes Vendore në Shqipëri, Plani i Zhvillimit të Bashkisë Krume e ka konsoliduar vlerën e tij ligjore dhe detyruese për zbatim, që në momentin e miratimit nga Këshilli Bashkiak Krume.

Për të siguruar një zhvillim koherent dhe të qëndrueshëm, është i nevojshëm një planifikim mbi promovimin e zhvillimit ekonomik lokal, ofrimin e më shumë shërbimeve me bazë publike, mbrojtjen e mjedisit, përmirësimin e kontrollit mbi territorin dhe proceset e Planifikimit urban. Këto janë detyrat kryesore për çdo njësi vendore. Në këtë mënyrë, Plani i Zhvillimit plotëson këto kriterë:

orienton veprimet e Bashkisë që të veprojnë sipas një vijimësie të qartë procesesh dhe aktiviteteve në vite,

i jep mundësi komunitetit lokal që të përpunojë një vizion të përgjithshëm, për të ardhmen e Njesisë Vendore, duke përcaktuar në të njëjtën kohë edhe misionin e autoriteteve vendore,

është një instrument që propozon një seri projektesh dhe veprimesh, të cilat Bashkia mund t'i adresojë në Qeverinë Qëndrore apo në partnerë të tjerë financiarë si psh: në agjencitë donatore, për të siguruar kështu financime të vazhdueshme,

Plani i zhvillimit - Bashkia Krume

është një instrument që vjen si rezultat i një procesi pjesëmarrës, në të cilin banorët kanë percaktuar nevojat e tyre, si dhe prioritetet për veprim, trajton çështjet prioritare që shqetësojnë jetën e përditshme të banorëve, plani është i njohur nga banorët, dhe i lejon autoriteteve të Bashkisë që të veprojnë në mënyrë transparente në mbështetje të tyre,

është një dokument që lejon veprime efektive, duke përfshirë në vetvete një proces monitorues, i cili mundëson rishikimin periodik të objektivave dhe veprimeve, vetë banorët janë të përfshirë në procesin e rishikimit.

Fleksibiliteti i këtij Plani mundëson hapësira për ndryshime të mundshme bazuar në kriteret e nevojave që mund të dalin si pasojë e situatave të ndryshme të paparishikuara, zhvillimeve të reja dhe përmirësimeve të vazhdueshme, që do të dalin si rezultat i punës së Pushtetit Vendor përgjatë zbatimit. Këto ndryshime do të realizohen duke iu referuar kërkesave dhe nevojave specifike, sipas grupeve përkatëse të interesit.

Plani i Zhvillimit është hartuar duke u bazuar në mundësitë reale të Bashkisë Krume, si në kuptimin e këndvështrimit të burimeve njerëzore ashtu dhe të atyre financiare, ndërkohë pa munguar dhe shmangur ato ndërhyrje të rëndësishme strategjike, të cilat mund të shkojnë përtej kapaciteteve apo burimeve ekzistuese të Bashkisë.

Ky dokument është i hapur ndaj propozimeve të përfshira, që janë diskutuar nga komuniteti, biznesi apo grupe të tjera, të cilat kanë një ndikim të rëndësishëm. Në këtë mënyrë Plani i Zhvillimit nxit rritjen e besimit përkundrejt pushtetit vendor, përgjegjshmërinë gjatë kohës së zbatimit të tij.

Administrata e Bashkisë Krume është aktori kryesor përgjegjës për zbatimin e këtij dokumenti, në linjë me procesin periodik të planifikimit dhe të buxhetimit. Të tjerë aktorë të përfshirë në proces do të japin ndihmesën e tyre në monitorimin dhe përditësimin e vazhdueshëm të planit.

Për shkak të tranzicionit në vazhdim, në Shqipëri priten ndryshime të shumta, që do të reflektohen padyshim në rajonin e Kukësit dhe në Bashkinë Krume. Për këtë arsye rishikimi i Planit të Zhvillimit duhet të jetë një subjekt reflektimi i vazhdueshëm. Plani duhet të rishikohet në mënyrë periodike, duke adoptuar dhe integruar ndryshimet e shkaktuara nga zhvillimet apo tendencat e reja të tranzicionit në Shqipëri.

HAPAT E NDJEKUR NË HARTIMIN E PLANIT TË VEPRIMIT (PV)

Nr	Aktivitetet	Kush	Koha	Vendi
	Ngritja e grupit të punës për hartimin e Planit të Veprimit	Stafi RASP	Shkurt 2012	Krume
	Trajnimi i antarëve të grupit për “Pjesëmarrja e komunitetit në	Stafi RASP	Mars 2012	Krume
	Mbledhja e të dhënave	Grupi i punës	Mars-Prill	Krume
	Analiza e situatës	Grupi i punës	Prill	Krume
	Takime me grupet e interesit - Grupi i grave e intelektualeve - Grupi i biznesit i të rinjve	Grupi i punës	Maj Qershor	- Krume
	Krijimi i grupit konsultativ	Grupi i punës, Drejtuesit Bashkisë	Qershor e 2012	Krume
	Përpunimi i draftit		Korrik Gusht	- Krume
	Marrja e vërejtjeve, sugjerimeve të komunitetit dhe konsultime me Këshillin Bashkiak		Gusht Shtator	- Krume
	Miratimi në Këshillin Bashkiak		Tetor	Krume

PËRMBLEDHJE E PROFILIT TË BASHKISË KRUME



HISTORIKU I QYTETIT TË KRUMES

Hasi në shek XVII njihet edhe me një emër tjetër si (Shulla), Pjeter Mazrreku 1586-1637 në shkrimet e tij përmend Shulla ose Has ku thotë se në këtë zonë jetojnë një numër i madh shqiptarësh mysliman.

Ndërsa S.Pulaha e lidh emrin e krahinës me Ndarjet Administrative të Perandorisë Osmane në “Nahije dhe Haseve” shek XV-XVI. Historia e krahinës së Hasit sipas burimeve të ndryshme mendohet të jetë vend i origjinës së Kastriotëve P.Luccari 1605 dëshmon se Kastrioti dhe Mazrreku kishin origjinë nga Krahina e Hasit afër Lumit Drin.

Pjetër Bogdani Lindi në Gure t`Hasit, vdiq në Prishtinë autor i veprës, 1657: “Ceta e Profetëve” kjo vepër ngelet një Gur themeli i gjuhës vjetër Shqipe.

Nga fundi shek. XVIII kemi krijimin e Bajraqeve: Bajraku i Madh(Vlahen) -Bajraku i Vogël (Helshan).

Nga fillimi i shek. XIX deri në fund të shek. XX kemi një mori ngjarjesh.

Në vitin 1921 Hasi bënte pjesë në Prefekturën e Kosovës ku përfshiheshin edhe Kukësi dhe Tropoja që njihnin si **Qendër Krumen** kjo deri me 1925.

Me vitin 1922 u hap shkolla shqipe në Krume, pak muaj më parë ku Bajram Curri i shkruan Ministrisë së Arsimit të Tiranës, ku kërkon për të hapur shkolla shqipe, në Has e Lume.


Në vitin 1923 në Krume u krijua Shoqëria Arsimore “SHKELZENI” e cila hapi kurse për zhdukjen e analfabetizmin, megjithëse në Krume kishte shtëpi dhe xhami, që shërbyen në atë kohë si vende ku mësonin gjuhën shqipe.

Në 1967-1987 në HAS janë ndërmarrë ekspedita të shumta arkeologjike ku janë zbuluar tuma (varre ilirësh) të cilat janë gjetur mori gjërash si punime qeramike të ndryshme etj.

Në Mars të 1972 nga Lokalitet Kruma u shpall si qytet. Në 1998-1999 ndihma që Hasianët ju dhanë popullit të Kosovës ishte e pranishme, këtë e dëshmon çdo shtëpi, dëshmorët lufta që dhanë për lirinë e Kosovës. Kjo luftë me ndihmën që NATO i dha Kosovës nuk ishte ndaj reformave të Tanzimatit dhe Otomanëve, por ndaj serbëve të ardhur në këto toka po i largonin nga tokat e tyre shekullore të madh e të vogël pa dallim, mbi 50 mijë Kosovarë kanë kaluar Qafën e Prushit


Pozicioni gjeografik dhe karakteristikat natyrore

POZITA GJEOGRAFIKE



Rrethi Hasit

Shkalla 1-160000



Kruma ndodhet në Veri-Lindje të Shqipërisë dhe 10 km afër kufirit me Kosovën.

Kruma është edhe kryeqendra e rrethit së Hasit.



Shtrihen në një lartësi prej 370-450 m mbi nivelin e detit. Ka një popullësi prej 7800 banorë.

Në qendër ka një shkollë të Mesme të Përgjithshme, konviktin “Kosova” Krumë , dhe një shkollë 9 vjeçare .

Popullësia ka ndryshuar gjatë dekadave të fundit, kryesisht për shkak të emigrimit.

Në Veri-Perëndim ndodhet Bjeshka Krumes, nga e cila vjen një burim i madh uji nëntokësor i quajtur Vrella me ujë të pastër dhe të ftohtë, nga ku furnizohet qyteti dhe disa fshatra përreth me ujë të freskët. Nga ky burim në fund të malit, fillon lumi Kruma i cili shkon në drejtim të Perëndimit.

Në anën Veri-Lindje të qytetit ka malin e Gajrepit me lartësi 1400 mbi nivelin e detit.

Në Perëndim shtrihet rrafshnalta e Hasit me toka pjellore ku ka një prodhimtari të mirë në pemë, vreshta dhe frutikulturë, ndërsa toka më pjellore është Plani i Krumes, i cili është i rrethuar nga kodra të buta dhe të ulta të cilat vazhdojnë deri në brigjet e liqenit të Fierzës.

Klima është tipike kontinentale. Vera është e nxehtë e më pak reshje dhe dimri i ftohtë me shumë dëborë e ngrica. Temperaturat mesatare vjetore variojnë nga 11-11.9 °C. Në verë temperaturat shpesh kalojnë mbi 25°C, ndërsa në dimër ato minimale mund të zbresin deri në -25°C. Reshjet vjetore renditen në diapazon 900-3000 mm dhe rreth 80% e tyre bien në periudhën Tetor-Mars.

Hasi gjatë viteve 70 filloi me industrinë nxjërrese me minerale të Kromit, Bakrit dhe të Hekur Nikelit dhe konkretisht:

Vendburimet më të mëdha janë njohur zonat e Vlahnes, Perollajt, Golaj(bakër), Nikoliqit(bakër), Krumes(bakër), Cahani(Gajrepi, Krom dhe Hekur Nikel).

Kjo industri gjate viteve 1980-1990 për shkak të shtimit të këtyre rezervave u quajt “Epoka e Mineraleve”.

Pyjet e Hasit. Larmishmëria e bimësisë e bën edhe më shumë tërheqëse për vizitorët dhe kuruesit. Pylli më i madh është ai i Gadhanit në zonën e Cahanit, zonë e cila është shpallur dhe "zonë e mbrojtur". Kjo zonë ka shumë resurse turistike që shtrihet që nga bjeshka e krumes e deri në majë të Pashtrikut, ku njihet me livadhet alpine dhe bukuri të rralla natyrore.

Hasi si rreth përbëhet nga 3 Komuna dhe një Bashki: Bashkia e Krumes, Komuna Golaj, Komuna Fajza, Komuna Gjinaj.

Hasi ka disa veçori karakteristike një nga të cilat është veshja. Veshjet karakteristike të Hasit si ajo e e grave dhe veçanërisht **Veshja e Vlahnes** e cila është karakteristike për hasin e Gurit, po kështu dhe **veshja e burrave** ka veçoritë e saj ku dallohen nga krahinat me të cilat kufizohemi. Një veçori tjetër është edhe **dialekti hasjan**.

Ne Has janë 30 monumente natyrore, 30 ha rezerva natyrore e menaxhuar. (Rethi i Hasit, Ahishtja e Liqenit te Kuq 12 ha).

POPULLSIA

TABLE 1 TË DHËNA PËR POPULLSINË

Lagje - Fshati	Popullsia	Meshkuj	Femra	Nr. familjeve
Lagje 1	1,960	995	965	380
Lagje 2	2,200	1,090	1,110	476
Qytet	4,160	2,085	2,075	856
Fshati Krume	1530	770	760	331
Fshati Gajrep	560	280	280	118
Fshati Cahan	180	91	89	36
Fshati Mujaj	290	145	145	68
Fshati Zahrisht	780	401	379	162
Fshat	3,340	1,687	1,653	715
TOTALI	7,500	3,772	3,728	1,571

NDIHMA EKONOMIKE

TABLE 2 FAMILJE ME NDIHMË EKONOMIKE

Nr	Lagje - Fshati	Numri i familjeve që trajtohen me ndihmë ekonomike
	Lagje Nr 1	165
	Lagje Nr 2	120
	Lagje Nr 3 (Kodra e madhe)	67
	Fshati Krume	122
	Fshati Zahrisht	78
	Fshati Gajrep	59
	Fshati Mujaj	43
	Fshati Cahan	24
	Fshati Pla i Pates (Jetojne ne qytet)	7
	Totali	685

STREHIMI DHE URBANIZIMI

Nga studimet e kryera në qytetin e Krumes, duke parë dhe zhvillimin demografik dhe atë urban, vëmë re se ka progres në disa aspekte. Megjithëse këto vitet e fundit popullsia e qytetit nuk është rritur (ka ndryshime të vogla), qyteti ka marrë një zhvillim në aspektin urban ku vetëm pas viteve ‘90 janë ndërtuar rreth 20 banesa.

FURNIZIMI ME UJË TË PIJSHËM

Duke parë zhvillimin e viteve te fundit, vihet re se dhe nevojat për ujë të pijshëm janë në rritje. Aktualisht, në qytet furnizimi me ujë bëhet nga ujësjellësi i vetëm i qytetit, ndërtuar në vitet 80 që nuk garanton furnizim ritmik të banorëve.

Problematike në këtë aspekt është furnizimi me orar dhe pamundësia e furnizimit me ujë për person. Kriteri themelor i planifikimit të sasisë

ditore të ujit në qytet duhet të jetë që komuniteti të ketë ujë pa ndërprerje gjatë gjithë ditës në rrjetin e shpërndarjes dhe me presion të stabilizuar. Sasia e ujit që duhet të përdoret nga një person sipas normave aktuale bashkëkohore. Nga studimet e kryera ne kemi rezerva të konsiderueshme ujore, por për shkak të infrastrukturës jo të mirë që ekziston, nuk kemi furnizim të rregullt me ujë.

RRJETI I KANALIZIMEVE

Në juridiksionin e Bashkisë Krume është sektori i shërbimeve që merret me administrimin e këtij procesi. Gjatë viteve të fundit është bërë rikonstruksion i plotë i magjistralit kryesor të ujrave të zeza në lagjet e qytetit. Por duhet theksuar se kolektori kryesor që mbledh të gjithë rrjetin e kanalizimeve të ujrave të zeza derdhet në përrua dhe nuk trajtohen. Këto ujëra janë të patrajtuara, ç'ka përbën një faktor të lartë ndotjeje dhe shtim të sëmundjeve diareike, të lëkurës, etj.

BURIMET DHE PËRDORIMI I ENERGIJE

Lagjet e qytetit dhe fshatrat në përbërje të Bashkisë Krume, furnizimin me energji e merr tërësisht nga rrjeti kombëtar. Burime alternative janë drutë e zjarrit dhe gazi natyror që aktualisht përdoren më pak. Energjia elektrike përdoret përgjithësisht për ndriçim, gatim e ngrohje, por si rezultat i rritjes së çmimit të energjisë elektrike dhe druve të zjarrit, vitet e fundit vihet re një përdorim më i gjeri i gazit si për gatim edhe ngrohje.



SISTEMI ARSIMOR

Shkolla e parë është hapur në 22 Tetor 1922 ndërsa si ndërtesë ajo sot është si Muze. Në vitin 1928 ishte ndërtesë një-katëshe dhe me vonë 1932 ndërtesa u bë dy-katëshe. Shkolla e Mesme është hapur në vitin 1970 dhe më vonë u hapën shumë degë si agronomi, zooteknik etj. Në vitin 1982 është bërë shkollë e Mesme e Përgjithshme dhe sot ka 850 nxënës

Plani i zhvillimit - Bashkia Krume

Kopshti parashkollor u hap me 1974, godina në kushte shume të mira me 200 fëmijë të moshës 3-6 vjeç.

Konvikti me emrin Kosova (i ngritur në 1962) ka 138 nxënës.

Janë tre shkolla 9-vjecare: një në Krumë me kapacitet 1050 nxënës, një në fshatin Zahrisht me kapacitet 110 nxënës, një në fshatin Mujaj me 40 nxënës.

TABLE 3 **TE DHËNA PËR EDUKIMIN**

	Kopshte			Shkolla vjeçare			Shkolla të Mesme			Fakultete		
	Nr	Femijë	Edukator e	Nr	Nxënë s	Mësues	Nr	Nxënë s	Mësues	Nr	student e	Pedagogë
Bashkia Krume	3	230	13	3	1227	58	1	794	32	-	-	-

SHËNDETI PUBLIK

Nr. mjekëve	infirmierët	mamitë
2 (mjek Familje)	12	(Mbulon spitali rrethit)

MJEDISI DHE GJELBËRIMI

Janë përmirësuar shumë ambientet e gjelbërta të qytetit dhe janë shtuar sipëfaqje të reja. Vlen të përmendet lulishtja e re në ish-tregun e qytetit.



Table 4 Siperfaqjet në m² dhe numri i pemëve

Emërtimi	Sipërfaqe të gjelbërta në qytet		Nr i pemëve ekzistuese	
	M ² faktike	Plani për vitin 2012	Nr. faktik copë	Planifikuar të mbillen në vitin 2012 cope
Bashkia Krume	16000	1200	830	100

MBETJET URBANE

Ashtu si në të gjithë qarkun Kukës, edhe në Bashkinë Krume çështja e mbetjeve urbane nuk është e zgjidhur. Realizohet shërbimi i grumbullimit të mbeturinave, por asgjë nuk është realizuar në drejtim të landfjeldeve apo riciklimit.

Qarku	Kukes
Bashkia	Krumë
Popullsia	7500
Ne fshat	3340
Në Qytet	4160
Familje	1571
Në fshat	715
Në Qytet	856
Struktura që funksionon në Bashki për menaxhimin e mbetjeve	Sektor
Specialista	1
Nr Personave në funksion të pastrimit	7
Pastrim ambientesh	4
Ngarkim dhe transport mbetjesh	3

Plani i zhvillimit - Bashkia Krume

Nr i njësisive (lagjeve)	6
Të futura në skemë pastrimi	4
Të pa futura në skemë pastrimi	2
Prodhimi Vjetor I mbetjeve	6550 ton/vit
Grumbullohet	6550 Ton/vit
Vend Depozitimi	Qafë-Barak (Zonë ish-kullotë)
Tipi i Vend Depozitimit	Ambient i Hapur
Me kompani	Jo
Vetë Bashkia	Po
Mjetet që disponohen	1 Traktor transporti me rrimorkë
Puntorë në dispozicion të ngarkim dhe transportit	3
Ndarja e mbetjeve	Nuk realizohet
Sasia	6550 ton/vit
A ndahen veç mbetjet spitalore?	Jo
Ku hidhen mbetjet spitalore?	Në të njëjtin vend depozitimi
A ndahen veç mbetjet rrezikshme?	Jo
Ku hidhen mbetjet e rrezikshme?	Në gropë depozitimi

INFRASTRUKTURA RRUGORE

Table 5 Të dhëna për infrastrukturën rrugore

Emërtimi	Gjatësia e rrugëve m ² sipas gjëndjes së tyre				Plani rikonstruksion Viti 2012 m ²
	Gjithsej m ²	Gjëndje të keqe m ²	Gjëndje mesatare m ²	Gjëndje të mirë m ²	
Bashkia Krume	64 200	6310	13850	5600	23 000

BIZNESET DHE PUNËSIMI

Bizneset pranë Bashkisë Krumë janë në përgjithësi biznese të vogla. Janë 100 biznese të vogla ndërsa biznese të mëdha janë 20. Klima për biznesin është përmirësuar, por mbetet shumë për t'u bërë me qëllim që të gjenerohen vende të reja pune.

Table 6 Të dhëna për biznesin

Emërtimi	Biznese prodhuese		Shërbime		Të tjera	
	Nr	Të punësuar	Nr	Të punësuar	Nr	Të punësuar
Bashkia Krume	7	9	114	146	20	25

TE ARDHURAT E BASHKISE KRUME

Të ardhurat vijnë nga taksat e biznesit të vogël, tarifat e pastrim gjelbërimit dhe tarifat e tjera që paguhen nga biznesi i vogel dhe biznesi i madh, si dhe banorët e Bashkisë Krumë, nga lejet e transportit. Këto të ardhura për afërsisht janë masën 70% .

Tabela 7 Numri i personelit Viti 2011

Emërtimi	Nr.personelit sipas strukturës	Administr.	Punonjës	Nr.Faktik në total	Me arsim të lartë	Me arsim të mesëm	Meshkuj	Femra	Femra në poste drejtuese
Viti 2011	64	23	41	64	24	40	39	25	-
Viti 2012	68	23	45	68	26	42	43	25	-

Tabela 8, Grandet dhe buxheti sipas viteve 2007 – 2012 Në lekë

Emërtimi	Viti 2010		Viti 2011		Viti 2012	
	Grand	Buxheti	Grand	Buxheti	Grand	Buxheti
Bashkia Krumë	34.716.000	46.416.251	38.303.496	49.122.024	32.741.298	46.518.645

Table 9. Buxheti për vitin 2012 – Bashkia Krume

Bashkia Krume	Emertimi	Shpërndarja sipas zërave kryesor															
		Buxheti gjithsej lek		Investime		Kopshte + Çerdhe		Sherbime publike		Qendra kulturore		Konvikti		Administrata		Te tjera	
		Leke	%	Leke	%	Leke	%	Leke	%	Leke	%	Leke	%	Leke	%	Leke	%
46.518.645		1.640.000	3.53	620.000	1.33	8.955.836	19.25	5.204.527	11.19	6.216.499	13.36	20.639.783	44.37	3.242.000	6.97		

OBJEKTIVAT E PERGJITHSHEM TE ZHVILLIMIT TE BASHKISE KRUME

- 1-Të rriten mundesitë për zhvillimin e turizmit në Bashkinë Krume
- 2-Të përmirësohet infrastruktura rrugore dhe sistemi vadtës në Bashkinë Krume
- 3-Të rritet sasia dhe cilësia e shërbimeve ndaj komunitet

MATRICA E PROJEKTEVE SIPAS VITEVE

MATRICA E PROJEKTEVE 2012

Nr	Emërtimi i aktivitetit Veprimi	Veprimi	Pritshmëria	Afati - viti	Fondi i nevojshëm 000/leke	Kush mund ta financojë	Indikatorët – Treguesit e matshëm
1	Rritja e efikasitetit të qendrës informative për turizmin	<p>1-Rritje e numrit të materialeve informative</p> <p>2-Rritje kapacitetesh për stafin e qendrës</p> <p>3-Rritje e numrit të aktiviteteve promovuese në media dhe një panair</p>	Qendër informative për turizmin me efikasitet të rritur	6 muaj	50000 30000 100000	Biznesi Bashkia OJF	<p>Numri i fletëpalosjeve të realizuara dhe cilësia e tyre</p> <p>Numri i personave të trajnuar</p> <p>Numri i artikujve në media</p> <p>Numri i pjesëmarrësve në panair dhe produktet e</p>

Plani i zhvillimit - Bashkia Krume

							ofruara
2	Ngritja e një strukture për hartim projektesh	1-Evidentimi i personave potenciale 2-Trajnimi i tyre nga Sekretariati Teknik ne Kukës per fondet IPA 3-Angazhimi i tyre	Staf i pergatitur për projekte të hartuara nga stafi i Bashkisë	6 muaj	30000	Bashkia Sekretaria ti Teknik në Kukës Qarku Kukës	Numri i personave të evidentuar, numri i personave të trajnuar.
3	Ri-ngritja e Muzeut historik të Krumes, promovimi i tij	1-Evidentimi i bazës materiale aktuale 2-Vlerësimi i gjëndjes së kësaj baze materiale dhe restaurimi i saj 3-Mbledhja e materialeve që disponohen nga aktorë të ndryshëm, sistemimi i tyre 4-Restaurimi i objektit për muzeun 5-Promovimi në një faqe interneti	Muze i ngritur Rritje e numrit të vizitorëve në qytet Fizibilitet turistik i përmirësuar	2 vite	25000	Donatore Bashkia	Muzeu i ngritur Numri i vizitorëve

MATRICA E PROJEKTEVE 2013

Nr	Emërtimi i Veprimi	Veprimi	Pritshmëria	Afati viti	Fondi nevojshëm 000/leke	Kush mund ta financojë	Indikatorët e Treguesit matshëm
	Rritja e efikasitetit të qendrës informative për turizmin	1-Rritje e numrit të materialeve informative 2-Rritje kapacitetesh për stafin e qendrës 3-Rritje e numrit të aktiviteteve promovuese në media dhe një panair	Qendër informative për turizmin me efikasitet të rritur	6 muaj	50000 30000 100000	Biznesi Bashkia OJF	Numri i fletëpalosjeve të realizuara dhe cilësia e tyre Numri i personave të trajnuar Numri i artikujve në media Numri i pjesëmarrësve në panair dhe produktet e ofruara
2	Ngritja e një strukture për hartim projektesh	1-Evidentimi i personave potenciale 2-Trajnimi i tyre nga	Staf i pergatitur për projekte të hartuara	6 muaj	30000	Bashkia Sekretariati Teknik në	Numri i personave të evidentuar, numri i personave

Plani i zhvillimit - Bashkia Krume

		Sekretariati Teknik ne Kukës per fondet IPA 3-Angazhimi i tyre	nga stafi i Bashkisë			Kukës Qarku Kukës	të trajnuar.
3	Ri-ngritja e Muzeut historik të Krumes, promovimi i tij	1-Evidentimi i bazës materiale aktuale 2-Vlerësimi i gjëndjes së kësaj baze materiale dhe restaurimi i saj 3-Mbledhja e materialeve që disponohen nga aktorë të ndryshëm, sistemimi i tyre 4-Restaurimi i objektit për muzeun 5-Promovimi në një faqe interneti	Muze i ngritur Rritje e numrit të vizitorëve në qytet Fizibilitet turistik i përmirësuar	2 vite	25000	Donatore Bashkia	Muzeu i ngritur Numri i vizitorëve

Nr	Emërtimi i aktivitetit i Veprimi	Veprimi	Pritshmëria	Afati - viti	Fondi nevojshëm 000/lekë	Kush mund ta financojë	Indikatorët - Treguesit e matshëm
1	Plani Rregullues i Bashkisë	Hartimi i Planit rregullues të Bashkisë	Mundësi për zhvillimin e planifikuar të territorit, mundësi zhvillimi për bizneset dhe zhvillimin urban.	1 vit	600000	Donatore Buxheti i Shtetit USAID	Sipërfaqja e territorit
2	Ngritja e një qendre informative për qytetarët me qëllim rritjen e reagimit qytetar	1-Hartimi i një programi informativ mbi të drejtat e qytetarëve 2-Përcaktimi i personave përgjegjës për informimin e qytetarëve 3-Përgatitja e materialeve informative 4-Organizimi i aktiviteteve mujore me komunitetin	Vetëdijësim i rritur i qytetarëve mbi të drejtat e tyre	1 vit	100 000	Bashkia OJF	Numri i materialeve informative Numri i takimeve ndërgjegjësuese me komunitetin Numri i kërkesave dhe ankesave të qytetarëve

Plani i zhvillimit - Bashkia Krume

3	Hartimi i projekteve	<p>1-Hartimi i projektit për ngritjen e një qendre multi-funksionale</p> <p>2-Hartimi i një projekti për sistemimin e bregut të liqenit të Fierzës në Zahrisht</p>	Projekte të hartuara për fëmijët me aftësi të kufizuara, rininë, për kurse profesionale si dhe projekte për zhvillimin e turizmit	1 vit	5,000,000 (te nevojshme për bashkëfinancime)	Bashkia OJF Qarku	Numri i projekteve të hartuara
4-	Rritje e bashkëpunimit mes Qeverisë Lokale dhe asaj Qëndrore	<p>1-Përgatitje dhe paraqitje projektesh në Qeverisjen Qendrore</p> <p>2-Lobim</p>	Mbështetje e rritur nga Qeverisja Qendrore	1 vit	200,000	Bashkia Qarku Persona kyç	Numri i projekteve të paraqitura dhe të miratuara
5	Fuqizimi i qendrës sociale për moshën e tretë	<p>1-Nënshkrimi i marrëveshjeve të partneritetit me donatorët aktuale të kësaj qendre</p> <p>2-Mbajtja në eficiencë e kësaj qendre</p>	Shërbime efçente për moshën e tretë	3 vite	180,000	Bashkia Donatorë	Numri i personave që do të frekuentojnë këtë qender

MATRICA E PROJEKTEVE VITI 2014

Nr	Emërtimi i aktivitetit Veprimi	Veprimi	Pritshmëria	Afati - viti	Fondi i nevojshëm 000/leke	Kush mund ta financojë	Indikatorët - Treguesit matshëm
1	Ngritja e një çerdheje për fëmijë	Përcatimi i një ambienti të përshtatshëm 2-Realizimi i preventivit 3-Rekrutimi dhe trajnimi i stafit	Shërbim i ofruar për fëmijët 1-3 vjeç	1 vit	7000000 Verifikim i vlerës	Donatorë	Çerdhja e ngritur Fëmijët që do ta frekuentojnë
2	Përmirësim i infrastrukturës rrugore	Asfaltim i rrugëve: Zahrisht-Pla Krume-Gjakovë	Më shumë mundësi për zhvillim socio-ekonomik	1 vit	1000000	Donatorë Qeveri Qëndrore	Metra lineare rrugë të asfaltuara
3	Përmirësim i sistemit vaditës	Rregullimi i kanalit vaditës në Zahrisht	Mundësi për zhvillim bujqësor	1 vit	30000000	Donatorë Qeveri Qëndrore & lokale	Kanal vaditës i rehabilituar
4	Përmirësimi i sistemit të grumbullimit dhe transportimit të mbeturinave urbane	1-Blerja e një makine për transportim të mbeturinave 2-Blerje kontenierësh	Ambient me i pastër dhe shendet më i garantuar për qytetarët	2 vite	10000000	Donatorë Qeveria Bashkia	Numri i makinave të transportit. Numri i kontenierëve në funksionim

Plani i zhvillimit - Bashkia Krume

MATRICA E PROJEKTEVE VITI 2015

Nr	Emertimi i aktivitetit Veprimi	Veprimi	Pritshmeria	Afati - viti	Fondi i nevojshëm 000/leke	Kush mund ta financoje	Indikatorët – Treguesit e matshëm
1-	Administrim i menaxhim i bjeshtëve në funksion të Turizmit	1-Hartim projekti për shfrytëzim të bjeshtëve në funksion të zhvillimit turizmit	Vlera natyrore të evidentuara dhe të vlerësuara Vlera kulturore të evidentuara dhe të vlerësuara Vlera të promovuara	1 vit	200.000	Donatorë Bashkia	Projekti i hartuar
2	Pëmirësim i infrastrukturës rrugore	1-Rikonstruksion i rrugës së fshatit Gajrep	Mundësi të rritura për zhvillim socio-ekonomik të qytetarëve	3 vite	15000000	Donatorë Fondi i zhvillimit Bashkia	Metër lineare të rrugëve të ndërtuara
3	Urbanizimi i Lagjes së Re perferike	1-Identifikimi i problematikës 2-Hartimi i planit urbanistik	Lagje e urbanizuar	2 vjet	9000000	Bashkia Donatorë	Metër linearë rrugë dhe metër katrore trotuare të ndërtuara

Plani i zhvillimit - Bashkia Krume

		3-Ndërhyrja për realizimin e urbanizimit					Sasi kanalesh të ndertuara
		Kanale të ujrave të zeza të sistemuara					
4	Sistemimi i përroit "Tershena" dhe rrugës në krah saj	1-Hartim Projekti 2-Preventivi dhe realizimi projektit	Mundësi të rritura për zhvillim socio-ekonomik të qytetarëve, rehabilitimi infrastrukturës, mjedis i pastër	1 vit	Projekti 400 Realizimi 40.000	Bashkia Donatorë	Gjatësia 1.5km, sip. Rrugës sistemuar në krah të përroit 5000 m2
5	Ndërtimi i godinës së Bashkisë	Realizimi i projektit	Ambient dinjitoz për administratën, dhe realizim shërbimi ndaj qytetarëve	1 vit	78.000	Donatorë Qeveri qëndrore Qeveri lokale	Sipërfaqe ndërtimore 450 m2/ 1 kat
6	Ndërtim KUZ (kanale ujra te zeza)	Hartim Projekti Preventi dhe realizimi i projektit	Ambient më i pastër dhe shëndet më i garantuar për qytetarët	1 vit	20.000	Donatorë Qeveri qëndrore FSH Zhvillimit	Gjatësia 7.5 km

Plani i zhvillimit - Bashkia Krume

7	Ndërtim i fushës së futbollit, dhe ambienteve sportive	Preventi dhe realizimi i projektit	Mundësi argëtimi dhe zhvillim i sporteve	1 vit	30.000	Donatorë Qëndrore Ministria Sporteve	Qeveri KR	9100 m2 fusha futbollit. 300m2 ambientet sportive(godinë)
---	--	------------------------------------	--	-------	--------	---	--------------	--

ANEX 1. GRUPI KONSULTATIV KRUME

Nr	Emri	Mbiemri	Vendbanimi	Telefon
1	Veli	Ibraj	Zahrisht	0692212447
2	Mirela	Lleshi	Lagje 3	0672313636
3	Drita	Meshi	Lagje 2	0692296804
4	Qazim	Mulaj	Lagje 2	-
5	Selman	Qema	Lagje 1	0683444871
6	Ismet	Peka	Lagje e vjeter	0682377151
7	Gezim	Cahani	Lagje 1	0694323780
8	Zek	Cahani	Lagje 2	-
9	Fatmir	Xhebexhia	Lagje e vjeter	-
10	Demush	Kastrati	Lagje 1	0695281847
11	Gjyle	Dauti	Lagje 2	0693397826
12	Shyrete	Koka	Lagje 1	0689015760
13	Bardhyl	Sadrija	Lagje 2	0693932826
14	Shkurte	Dauti	Lagje 3	0695223694
15	Xhemile	Qaushi	Zahrisht	0685687410

VENDIMI I KESHILLIT BASHKIAK



REPUBLIKA E SHQIPERISË
BASHKIA KRUMË
KËSHILLI BASHKIAK

Adresa: Sheshi "Deshmoret e Hasi", Pallati i Kultures "Pjeter Bogdani", Qyteti Krume, Rrethi Has.
Tel/Fax.: +355 214 22080. E-mail: bashkiakrum@yaho.com.

V E N D I M

Nr. 62, datë 26 .11 . 2012

PËR

"MIRATIMIN E PLANIT VEPRIMIT TË BASHKISË KRUMË 2012-2016"

Në mbështetje të nenit 7, të ligjit Nr.8652, datë 31.07.2000 për "Organizimin dhe Funksionimin e Qeverisjes Vendore" (i ndryshuar); dhe pas shqyrtimit relacionit në lidhje me "Planin e Veprimit të Bashkisë Krumë për vitet 2012-2016", i propozuar nga Kryetari i Bashkisë, Këshilli Bashkiak,

V E N D O S I:

1. Të miratojë "PLANIN E VEPRIMIT TË BASHKISË KRUMË 2012-2016".
2. Për zbatimin e tij, ngarkon administratën e Bashkisë Krumë.
3. Vendimi hyn në fuqi 5 (pesë) ditë pas shpalljes.



KRYETARI
Selman GECA